



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

NR. 110, Datë 29 / 12 / 2022

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. POLO XHORI”

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z. Polo Xhori, si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën 29 . 12 2022, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Drejtoria e Kulturës për dhënie titulli "Qytetar Nderi" për Z. Polo Xhori, si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për dhënien e titujve të nderit,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e titullit **“Qytetar Nderi”** Z. Polo Xhori, për (pas vdekjes) me motivacionin:

“Në shënjë rrespekti dhe vlerësimi për kontributin e tij për edukimin e brezit të ri gjirokastrit si mësues muzike, për kontributin si violinë e parë në Orkestrën Simfonike të Gjirokastrës, për kontributin si përkthyes, dhe për promovimin në SHBA të vlerave të trashëgimisë kulturore, folkorike, arkitekturore, urbanistike dhe historike të Gjirokastrës dhe si një intelektual i formuar”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Turizmit dhe Sporteve.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” .

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi Hasani